

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIKI I KOSOVËS QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	Nr. Prot: Broj Prot:
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data: Datum: Date:
010 2 Prishtinë / a	32/18 19/11/20 20



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/ Ministry of Education,  
 and Science

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 013-133  
 Datë: 19.11.2020

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), Udhëzimit administrativ nr. 13/2018 për sistemin e menaxhimit të informatave në arsimin e lartë, nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 6/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e dt. 06.06.2020 dhe nenit 4 të Rregullores (QRK) – nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) – nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dt. 16.06.2020, nxjerr:

## V E N D I M

### Për shtyrjen e afatit për vendosjen e të dhënave në SMIAL

1. Shtyhet afati për regjistrim të studentëve për nivelin e studimeve bachelor të institucioneve publike dhe private deri më 27.11.2020, kurse për nivelin e studimeve master deri me datën 30.11.2020.
2. Shtyhet afati i vendosjes së studentëve për nivelin e studimeve bachelor të institucioneve publike dhe private në sistemin SMIAL, deri më datën 30.11.2020, kurse për nivelin master afati për vendosje të studentëve mbetet me 04.12.2020.
3. Dorëzimi i regjistrave (librit amë) për nivelin bachelor bëhet deri me datën 01.12.2020, kurse për nivelin master deri me datën 10.12.2020, për të dy nivelet (5 ditë pune).
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m

Duke u bazuar në kërkesat e IAL-ve publike dhe private që mundësisht të shtyhet afati i vendosjes së studentëve në sistemin SMIAL, ku sipas Udhëzimit administrativ 13/2018 janë të përcaktuara afatet për nivelin bachelor dhe master, ku Ministri në raste të veçanta mund të nxjerrë vendim për shtyrjen e afateve për vendosjen e studentëve në sistemin SMIAL dhe duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Kabinetit të Ministrisë/ MASH;
2. Zyrës së SP/ MASH;
3. DALSH/ MASH;
4. Arkivit.





REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministry of Education Science & Technology  
Nëntësia e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 21548  
Datë: 13/11/2020

**Për:** Prof. dr. Ramë Likaj, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë-Republika e Kosovës

**Nga:** Prof. dr. Naser Sahiti, Rektor i Universitetit të Prishtinës

**Lënda:** Kërkesë për shtyrje të afatit për vendosjen e të dhënave të studentëve të Universitetit të Prishtinës në SMIAL-it, për t'ua mundësuar kandidatëve për studentë në nivelin baçelor dhe master, zëvendësimin e kuotave të rezervuara për komunitete dhe për studentë nga viset tjera jashtë Kosovës

I nderuar z. Ministër,

Konferenca e Rektorëve të IPAL, javën e kaluar ka bërë kërkesë për lejim të plotësimit të kuotave të cilat kanë qenë të parapara për komunitetin jo shumicë dhe për kandidatë nga viset e tjera jashtë Kosovës, të banuara me shqiptarë, ndërsa dje kemi pranuar përgjigjen e MASH-Shkresa nr. nr. 3081, datë 11.11.2020, sipas së cilës çështja e vendimmarrjes mbetet në kompetencë të Konferencës së Rektorëve.

Konferenca e Rektorëve në mbledhjen virtuale të mbajtur me datë 12.11.2020 ka nxjerr rekomandim nr. 2/545, dt. 13.11.2020, përmes së cilës ka rekomanduar Universitetet publike që të bëjnë plotësimin e vendeve të lira. Universiteti i Prishtinës menjëherë ka filluar procesin për njoftimin e kandidatëve në pritje për të plotësuar vendet e lira sipas renditjes në listat e kandidatëve të pa pranuar (të cilët e kanë kaluar pragun e kalueshmërisë), mirëpo ky proces merr kohë disa ditë, prandaj me mirëkuptim kërkojmë që për tu realizuar ky proces të lejohet shtyrja e afatit për vendosjen e të dhënave të studentëve të Universitetit të Prishtinës në SMIAL-it dhe atë sipas afateve në vijim:

1. Shtyhet afati për regjistrim të studentëve për nivelin e studimeve baçelor deri më datë 27.11.2020, kurse për nivelin e studimeve master deri më datë 30.11.2020.
2. Shtyhet afati i vendosjes së studentëve për nivelin e studimeve baçelor në sistemin SMIAL deri më datë 30.11.2020, kurse për nivelin e studimeve master deri më 04.12.2020.
3. Dorëzimi i regjistrave (librit amë) për nivelin e studimeve baçelor bëhet deri më datë 01.12.2020, ndërsa për nivelin e studimeve master deri më datë 10.12.2020, për të dy nivelet (5 ditë pune).

Ju faleminderit për mirëkuptim dhe bashkëpunim!

Me respekt,

Prof. dr. Naser Sahiti,

Rektor i UP-së

